



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.209/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura në 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

**VE N D I M**

I. **PRANOHET e BAZUAR** ankesa ZL.Anr.209/2025 e datës 14.10.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë .

II. Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 500.00Euro (pesëqindë Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datën 14.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën pretendon se më datë 12.10.2025, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Gjakovë kanë vërejtur se në rrjetin social Facebook, kandidati për kryetar të komunës së Gjakovës nga radhët e Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini ka postuar fotografi duke votuar, derisa në sakon e tij kishte simbolin partiak të AAK-së. Sipas parashtruesit të ankesës, Ardian Gjini me këtë veprim ka bërë shkelje të nenit 37 të Ligjit 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës që ndalon çdo aktivitet fushate gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024. Si provë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin që dëshmon shkeljen e tillë në ditën e zgjedhjeve.



Në përgjigje në ankesa Subjekti Politik AAK , ka theksuar se kandidati për kryetar të Gjakovës nga subjekti i tyre, Ardian Gjini, nuk ka zhvilluar apo nxitur fushatë zgjedhore qoftë gjatë periudhës së heshtjes apo në ditën e votimit. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se postimi në fjalë në rrjetin social Facebook ka pasur vetëm karakter personal dhe informues, përmes të cilit është inkurajuar pjesëmarrja e qytetarëve në procesin demokratik të votimit dhe përmes të cilit i njëjti ka njoftuar se ka shfrytëzuar të drejtën e votës. Sipas tyre, në përmbajtjen e postimit nuk ekziston asnjë element i fushatës zgjedhore, as thirrje për votim për ndonjë subjekt apo kandidat e as promovim politik . Publikimi i një fotografie personale duke ushtruar të drejtën e votës është shprehje e lirë dhe e drejtë e çdo qytetari dhe nuk mund të barazohet me “aktivitet fushate”. Tutje shtojnë se në fotografinë e bashkangjitur nga parashtruesi i ankesës si provë, nuk vërehet qartë se çfarë simboli, logoje apo shenjë është vendosur në sakon e kandidatit. Pamja e fotografisë është e turbullt dhe nuk lejon identifikimin e saktë të ndonjë simboli partiak, prandaj pretendimi se aty paraqitet simboli i subjektit politik AAK është vetëm supozim dhe jo fakt i provuar. Subjekti politik AAK pretendon se ankesa është e pasafatshme në përputhje me dispozitën ligjore e nenit 39 , par.3 të LZP-së për shkak se e njëjta është dorëzuar pranë PZAP-së me datë 14.10.2025 ora 11:20 , ndërsa afati për paraqitjen e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Lajmi se kandidati do votoj është publikuar në 10:46 dhe vërtetohet lehtë me publikimin e medimeve si lajmi.net. Andaj subjekti politik AAK kërkon nga PZAP-i që ankesën në këto rrethana, ta refuzojë në tërësi ose ta hedhë poshtë si të pasafatshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

#### **Ankesa është e bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik AAK , vlerësoj se pretendimet e Subjekti Politik LVV janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet .”*Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1 shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; 1.2.bërja e fushatës në çfarëdo mënyre. Si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se : Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.*

Në përgjigje të ankesës, ku kundërshtohet pretendimi ankimor, se postimi i kandidatit për kryetar të Gjakovës nga subjekti politik AAK, Ardian Gjini nuk përmban asnjë element të fushatës zgjedhore, as thirrje për votim për ndonjë subjekt apo kandidat e as promovim politik. Publikimi i një fotografie personale duke ushtruar të drejtën e votës është shprehje e lirë dhe e drejtë e çdo qytetari dhe nuk mund të barazohet me “aktivitet fushate”.



Paneli ka konsideruar se postimi i fotografisë duke votuar, derisa në sako është vendosur simbolin partiak i AAK-së është veprim që bie në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë në vendvotim e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit. Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme." Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e përgjigjes në ankesë të subjektit politik AAK dhe gjeti se e ankesa nga subjekti politik LVV është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se kandidati, Ardian Gjini, ka bërë publikimin në rrjetin social Facebook me datë 12 Tetor 2025 në ora 13:56 minuta kurse në përgjigje subjekti politik AAK ka bashkangjitur një publikim të lajmit nga lajmi.net se kandidati në fjalë ka votuar në orën 10:46 të datës 12 Tetor 2025, ndërsa ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV pranë PZAP-it është në datën 14 Tetor 2025 në orën 10:50, pretendimet ankimore lidhen me postimin në rrjetin social Facebook dhe jo më kohën kur kandidati ka shkuar të votoj, që tregon se nuk qëndron edhe pretendimi se ankesa është e pasafatshme.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Rregullores zgjedhore 07/2024. Poashtu, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.Anr.209/2025 më datën 15.10.2025



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.